
Metodologjia për rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK ne përputhje me Artikullin 157(1) të Rregullores së Komisionit (EU) 2017/1485 të datës 2 Gushtit 2017 mbi themelimin e udhëzuesit për operimin e sistemit transmetues

1. TSO-të e Bllokut LFC AK duhet te përcaktojnë kapacitetin rezervë të kërkuar për FRR të Bllokut AK duke u bazuar në të dhënat historike te viteve te kaluara të cilat përmbajnë së paku vlerat historike për disbalancet e Bllokut LFC AK. Për këtë qëllim përdoren të dhënat mesatare 15-minutëshe për periudhën kohore ndërmjet 1 Korrikut të vitit paraprak dhe 30 Qershorit të vitit aktual, por në qoftë se të gjitha palët dakordohen, mund të përdoret ndonjë periudhë tjetër kohore. Monitoruesi i Bllokut LFC është i obliguar që të bëjë grumbullimin e këtyre të dhënave.
2. Të gjitha TSO-të e Bllokut LFC AK përcaktojnë kapacitetin rezervë për FRR që është e mjaftueshme për të respektuar parametrat aktual të synuar të FRCE në përputhje me marrëveshjen „Marrëveshja e të gjitha e TSO-ve të Evropës Kontinentale (CE) për parametrat e synuar për restaurimin e gabimit të rregullimit të frekuencës, në përputhje me nenin 128 dhe nenin 131 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht, për krijimin e Udhëzimit për funksionimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (All CE TSOs’ Agreement on frequency restoration control error target parameters in accordance with Article 128 and Article 131 of the Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August establishing a Guideline on electricity transmission system operation“) për periudhën kohore të referuar në paragrafin e parë duke u bazuar së paku në një metodologji probabilitike. Përveç metodologjisë probabilitike, kapaciteti rezervë i kërkuar i FRR nuk mund të jetë më i vogël se incidenti referent për kahjen përkatëse.
3. Incidenti pozitiv për dimensionim të FRR të Bllokut LFC AK është i barabartë me rënien e modulit më të madh gjenerues në Bllokun LFC AK, në përputhje me Artikullin 157(2.d) të SO GL.
4. Incidenti negativ për dimensionim të FRR të Bllokut LFC AK është i barabartë me rënien e stabilimentit më të madh të konsumit në Bllokun LFC AK, në përputhje me Artikullin 157(2.d) të SO GL.
5. Incidenti pozitiv për dimensionimin e FRR për secilin TSO është i barabartë me rënien e modulit më të madh gjenerues të TSO përkatëse, në përputhje me Artikullin 157(2.d) të SO GL.
6. Incidenti negativ për dimensionimin e FRR për secilin TSO është i barabartë me rënien e stabilimentit më të madh të konsumatorit të TSO përkatëse, në përputhje me Artikullin 157(2.d) të SO GL.

7. Të gjitha TSO-të e Bllokut LFC AK duhet të sigurohen që kapaciteti i rezervës pozitive për FRR është i mjaftueshëm për mbulimin e disbalanceve pozitive të LFC Bllokut AK së paku 99 % të kohës, duke u bazuar në të dhënat historike të referuara në paragrafin e parë.
8. Të gjitha TSO-të e Bllokut LFC AK duhet të sigurohen që kapaciteti i rezervës negative për FRR është i mjaftueshëm për mbulimin e disbalanceve negative të Bllokut LFC AK së paku 99 % të kohës, duke u bazuar në të dhënat historike të referuara në paragrafin e parë.
9. Përpjesa e kapacitetit rezervë të FRR në drejtim pozitiv që kërkohet nga secila TSO P_i si obligim për FRR për vitin kalendarik t në shqyrtim do të bazohet në shprehjen vijuese për të gjitha TSO-të e Bllokut LFC AK:

$$P_{i,t+} = FRR_{+dimensioning} * \left[\frac{\max(+FRR_{i,det_need}, +FRR_{i,prob_need})}{\sum \max(+FRR_{i,det_need}, +FRR_{i,prob_need})} \right]$$

Ku:

- $P_{i,t+}$ është obligimi fillestar për FRR për TSO i për vitin kalendarik t ;
 - $FRR_{+dimensioning}$ është vlera e dimensionimit te FRR e llogaritur për Bllokun LFC AK;
 - $+FRR_{i,det_need}$ është kapaciteti rezervë në zonën rregulluese i gjatë periudhës që i referohet në paragrafin e parë, e llogaritur sipas metodologjisë probabilitike, d.m.th. e barabartë me incidentin qe merret gjate dimensionimit pozitiv te rezervës për atë TSO;
 - $+FRR_{i,prob_need}$ është kapaciteti rezervë në zonën rregulluese gjatë periudhës së referuar në paragrafin e parë, e llogaritur sipas metodologjisë probabilitike, d.m.th. kapaciteti rezervë pozitiv i FRR është i mjaftueshëm që të mbuloj disbalancet pozitive të TSO së paku 99 % të kohës t ;
10. Përpjesa e kapacitetit rezervë të FRR në kahun negativ për secilin TSO P_i për obligimin për FRR për vitin kalendarik t në shqyrtim do të bazohet në shprehjen vijuese për të gjithë TSO-të e Bllokut LFC AK:

$$P_{i,t-} = FRR_{-dimensioning} * \left[\frac{\max(-FRR_{i,det_need}, -FRR_{i,prob_need})}{\sum \max(-FRR_{i,det_need}, -FRR_{i,prob_need})} \right]$$

Ku:

- $P_{i,t-}$ është obligimi fillestar për FRR për TSO i për vitin kalendarik t ;
- $FRR_{-dimensioning}$ është vlera e dimensionimit te FRR e llogaritur për Bllokun LFC AK;

- $-FRR_{i,det_need}$ është kapaciteti rezervë në zonën rregulluese i gjatë periudhës së referuar në paragrafin e parë, e llogaritur sipas metodologjisë probabilitike, d.m.th. e barabartë me incidentin që merret gjatë dimensionimit negativ të rezervës për atë TSO;
 - $-FRR_{i,prob_need}$ është kapaciteti rezervë për zonën rregulluese gjatë periudhës së referuar në paragrafin e parë, e llogaritur sipas metodologjisë probabilitike, d.m.th. kapaciteti rezervë negativ i FRR është i mjaftueshëm për mbulimin e disbalanceve negative të TSO së paku 99 % të kohës t ;
11. Çdo vit, por jo më vonë se 15 Korrik, TSO-të e Bllokut LFC AK duhet ti ofrojnë njëri tjetrit të dhënat e nevojshme për të bërë llogaritjet e përmendura më sipër.
12. Çdo TSO në Bllokun LFC AK përcakton në mënyrë të pavarur raportin e FRR automatike, FRR manuale, kohën për aktivizimin e plotë të FRR automatike dhe kohën për aktivizimin e plotë të FRR manuale me qëllim që të jete në përputhshmëri me parametrat e synuar të FRCE.